



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Vleresimi i Korporatave
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa
Master

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Prill 2018

Vleresimi i Korporatave

- Viti I-të, Semestri II
 - Departamenti : KF - Master
 - Statusi i lëndes : Obligative
 - Javët mësimore: 15 [3 orë ligjerata, 2 orë ushtrime]
 - Mësimdhënes: Prof.Asoc. Dr. Rrustem Asllanaj
 - Asistent: MSc. Valdrin Misiri
 - Orari i ligjeratave: E premte (G1 – ora 15:00 – 17:15 A1)
 - Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 16:30 – 18:00 B1)
-
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
 - Website: www.unhz.weebly.com

Modeli i rritjes variabile (diferenciale) te dividendes

- Nese supozojme se firma ka paguar dividend per aksion ne vitin 2010 atehere cmimi i aksioneve eshte i barabarte:
- **Cmimi i aksionit me 31.12.2010(P_0) = V.T. e te gjitha dividendeve + V.T. e cmimit te aksionit ne fund te fazes se rritjes se dividendit**
- $$P_0 = \frac{D_1}{k_s - g_2}$$
- $$D_1 = D_0 x (1 + g_2)$$

Modeli i rritjes variabile (diferenciale) te dividendes (hapat)

- Hapi I: Ne baze te vleres se dividendes dhe g_1 gjejme vleren e ardhshme dhe pastaj vleren e tashme me kthimin e kerkuar.
- Hapi II: $D_1 = D_0 x (1 + g_2)$
- Hapi III: $P_0 = \frac{D_1}{k_s - g_2}$
- Hapi IV: E gjejme V.T. të P_0 në baze te kthimit te kerkuar
- Hapi V: **Cmimi i aksionit me 31.12.2010(P_0) = V.T. e te gjitha dividendeve + V.T. e cmimit te aksionit ne fund te fazes se rritjes se dividendit**

Shembull 1:

- Supozojme se aksionet e kompanise XYZ pritet ne vitet e ardhshme te kene rritje te cmimit. Dividendi per aksion nga sot deri ne fund te vitit te pare eshte 1.50 per aksion. Ne 3 vitet e ardhshme dividendi pritet te rritet 12%. Pas vitit te trete rritja e dividendit pritet te jete e barabarte me 10% ne cdo vit.
- Llogaritni cmimin e aksioneve ne fillim te vitit, nese kthimi i kerkuar eshte 15%.

Shembull 2:

- Firma Forex në fund të vitit 2014 ka paguar dividend 1.30 euro për aksion. Prej 1 janarit 2015 në 4 vitet e ardhshme pret që norma e rritjes së dividendit të jetë konstante prej 9%, pas kësaj rritje dividendi pritet të jetë 5% në vit.
- Sa duhet të jetë vlera e aksionit me 31.12.2014 nëse kthimi i kërkuar është 12%. Llogaritni vlerën e aksionit duke përdorë modelin e rritjes variabile të dividendit.

Shembull 3:

- Kompania Traffic eshte nje agjensi digjitale e marketingut e cila pret te mbaje dividend konstant prej 12 euro per aksion per disa vite ne vijim. Ne qoftese vlera e kthimit te kerkuar ne aksion eshte 13%, atehere sa duhet te jete vlera e aksioneve?

Shembull 4:

- Supozojmë se ju sot në revistat e Wall Street-it vëreni se çmimi për aksion i kompanisë XYZ është 35 euro dhe se dividendi në fund të vitit të kaluar është 1.50 euro për aksion. Në qoftë se revista ndërkombëtare e bursave vlersojnë që dividendi për aksion rritet në çdo vit 4.35%.
- Llogaritni normen e kthimit të kërkuar (norma e kapitalizimit) përmes modelit të rritjes konstante të dividendit?

Vleresimi i pasurise

- Ne përgjithësi janë katër nivele të vlerësimit ne lidhje me pasuritë e biznesit:
 1. Permes vleres se tregut,
 2. Vlerës e kontabel apo ne libra,
 3. Vlerës së likuidimit
 4. Vleres rikuperuese ose e mbetur.
- Çdo nivel i vlerës siguron një mënyrë për kontabilistët dhe analistët për të klasifikuar vlerën totale të aseteve.
- Vlera likuiduese është veçanërisht e rëndësishme për ato firma që punojnë me falimentime.

Vlera likuiduese per aksion

- Vlera likuiduese është me vlera totale e asetëve fizike të kompanisë, kur ajo likuidohet ose mbyllet.
- Vlera likuiduese përcaktohet nga asetet të tilla si pasuri të patundshme, instalime, pajisje dhe nga inventari.
- Aktivet jo-materiale nuk janë të përfshira në vlerën e likuidimit të një kompanie.

Market Vs. Book Vs. Liquidation Vs. Salvage

- **Vlera e tregut** në përgjithësi është vlera më e lartë e aseteve, edhe pse ajo mund të jetë më e ulët se vlera kontabël në qoftë se vlera e aseteve ka zbritur në vlerë për shkak të kërkesës së tregut dhe jo nga përdorimi i biznesit.
- **Vlera kontabël** është vlera e aktivitetit e listuar në bilancin e gjendjes.
- **Vlera e likuidimit** është vlera e pritur e aktivitetit pasi që ajo ka qenë likuiduar ose shitur, sic duket më një humbje të kostos historike.
- Së fundi, **vlera rikuperuese** është vlera e dhënë e një aktivi në fund të jetës së tij të dobishme; me fjalë të tjera, kjo është vlera copez ose e mbetur.
- Vlera likuiduese është zakonisht më e ulët se vlera e ne libra, por më e madhe se sa vlera e rikuperuese ose e mbetur.

Vlera likuiduese per aksion

- Formula per llogaritjen e ketij raporti eshte si vijon:

- $$\text{Vlera likuiduese per aksion} = \frac{\text{Totali i kapitalit aksionar sipas vl.likuiduese}}{\text{Numrin e aksioneve te emetuar}}$$

- Ose...

- $$\text{Vlera likuiduese per aksion} = \frac{\text{Totali i pasurise (v.l.)} - \text{Totali i detyrimeve (a.p.)}}{\text{Numrin e aksioneve te rregullta ne zotrim}}$$

Shembull:

- Kompania Foxconn zoteron pasuri ne vlere prej 2.530.000€, nese te gjitha keto pasuri shiten aktualisht. Vlera e ketyre pasurive ne momentin e shitjes percaktohet ne baze te vleres se tregut.
- Vlera e tregut te gjitha detyrimeve bashke me aksionet preferenciale eshte 1.440.000 €.
- Llogaritni vleren likuiduese per aksion, nese kompania ka 78.000 aksione ne zoterim.

Vlera kontabel per aksion

- Vlera kontabel per aksion tregon shumen e regjistruar ne kontabilitet per cdo aksion te rregullt, te cilat jane ne zotrim te aksionereve.
- Vlera kontabel per aksion llogaritet si pjesetim i kapitalit aksionar te pakesuar per aksionet preferenciale dhe numrit te aksioneve ne zoterim ne daten e llogaritjes.

Vlera kontabel per aksion

- Formula per llogaritjen e ketij raporti eshte si vijon:

- $$\text{Vlera kontabel per aksion} = \frac{\text{Totali i kapitalit aksionar (Ekuiteti)}}{\text{Numrin e aksioneve te emetuara}}$$

- Ose...

- $$\text{Vlera kontabel per aksion} = \frac{\text{Totali i pasurise (v.k.)} - \text{Totali i detyrimeve(a.p.)}}{\text{Numrin e aksioneve te rregullta ne zotrim}}$$

Shembull 1:

- Ne fund te vitit 2012 Kompania Buffalo ne bilancin e saj ka totalin e pasurise prej 8 milion euro. Totali i detyrimeve 5.5 milion euro, duke l perfshire edhe aksionet preferenciale. Ne kete date Buffalo Company ka ne zotrim 80.000 aksione te zakonshme.
- Llogaritni vleren kontabel per aksion.

Shembull 2:

- Në fund të vitit 2010 totali i pasurisë sipas vlerës kontabël të kompanisë M është 500.000 euro, ndërsa totali i detyrimeve është 160.000 euro. Llogaritni vlerën kontabël për aksion nëse kompania M ka në zotrim 7000 aksione.

Pyetje



Suksese!